



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 1482 prot.

Shkodër, më 27.01. 2026

VENDIM

Nr. 5, datë 26.01.2026

**PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR. 27, DATË 01.06.2016, “PËR NGRITJEN E
KËSHILLIT ARTISTIKO-KULTUROR, SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË TIJ DHE
MIRATIMIN E RREGULLORES SË FINANCIMIT TË PROJEKTEVE KULTURORE,
ARTISTIKE, SPORTIVE, RINORE DHE PROMOVIMIN E TERRITORIT NË
BASHKINË SHKODËR”, TË NDRYSHUAR**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 26.01.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, bazuar në nenin 8, pika 2, dhe nenin 25 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; Vendimin nr. 540, datë 21.12.1992, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e këshillave artistiko-kulturorë dhe për shpërblimin e anëtarëve të tyre”, të ndryshuar; Udhëzimin nr. 1, datë 24.05.2005, të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këshillave artistiko-kulturorë”; VKB nr. 27, datë 01.06.2016, “Për ngritjen e Këshillit Artistiko-Kulturor, shpërblimin e anëtarëve të tij dhe miratimin e Rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistike, sportive dhe rinore në Bashkinë Shkodër”, të ndryshuar; si dhe VKB nr. 84, datë 18.12.2025, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026–2028 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar, si dhe dokumentacionit të përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër,

VENDOSI:

1. Të miratojë një ndryshim në VKB nr. 27, datë 01.06.2016, “Për ngritjen e Këshillit Artistiko-Kulturor, shpërblimin e anëtarëve të tij dhe miratimin e Rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistike, sportive, rinore dhe promovimin e territorit në Bashkinë Shkodër”, të ndryshuar, si më poshtë:

a) Të miratojë ngritjen e Këshillit Artistiko-Kulturor pranë Bashkisë Shkodër, për një periudhë dy vjeçare 2026–2028, si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër	Aktiviteti i tyre në shërbim të artit, kulturës dhe sportit
1	Sara Smajaj	Drejtores e Drejtorisë së Kulturës, Drejtoria e Përgjithshme e Kulturës dhe Sportit
2	Zyliha Miloti	Aktore e Teatrit dhe filmit, Mjeshtër i Madh
3	Zef Çoba	Kompozitor, Mjeshtër i Madh
4	Ridvan Karakaçi	Muzikolog dhe kritik arti
5	Roland Guli	Kompozitor, profesor në Departamentin e Arteve, Universiteti “Luigj Gurakuqi”
6	Andi Hila	Piktor, vizual art, profesor në Departamentin e Arteve, Universiteti “Luigj Gurakuqi”
7	Arbana Bekteshi	Mjeshtër i Madh, Mjeshtër i Merituar në atletikë, profesor në Departamentin e Arteve, Universiteti “Luigj Gurakuqi”

2. Pikat e tjera të VKB-së nr. 27, datë 01.06.2016, të ndryshuar, mbeten në fuqi

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miraturar me 28 vota

Vota Pro 28
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 9
Zbardhur me datë 27.01.2026

SEKRETARE

Sabina Danaj

